



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

№:
No. 02-350/01-0032801/24
Data:
Data. 12.07.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në bazë të nenit 5 shkronja d), nenit 17, nenit 58 shkronja a) dhe c), të Ligjit për Vetqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 2 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenit 21 nenit 60 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative 05/L-031, në përputhje të plotë me nenin 39, paragrafi 2 dhe paragrafi 5, nënparagrafi 5.1, të Udhëzimit Administrativ MMPH-nr. 24/2015, Harten Zonale të Komunës së Skenderajt nr. 01-350/01-0055085/20 të dt. 29.12.2020, në përputhje me objektivat, qëllimet, vizionin dhe strategjitë e Planit Zhvillimor Komunal, Statutit nr.Nr.01-110-385 të datës 03.12.2008 të Komunës së Skenderajt, me dt.12.07.2024 lidhet kjo:

MARRËVESHJE

ZHVILLIMI

Ndërmjet:

1. **Komunës së Skenderajt**, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës **z.Fadil Nura** me adresë rr."28 Nëntori" Skenderaj,(në tekstin e mëtejme Komuna), dhe
2. **Personit Juridik "XANI & PARTNERS" Sh.P.K**, me përfaqësues **z.Hysni Xani**, Mitrovicë (në tekstin e mëtejme aplikuesi).

Neni 1

Lënda

Lëndë e kësaj marrëveshje është përcaktimi i bonuseve të zonimit të parapara në kuadër të Hartës Zonale të Komunës së Skenderajt nr. 01-350/01-0055085/20 të dt. 29.12.2020, të ofruara për aplikuesin si mjet stimulimi që e shfrytëzon Komuna e Skenderajt, në këmbim për realizimin e përfitimit publik, projekti me titull: "Rehabilitimi i Sheshit para Shtëpisë së Kulturës në Skenderaj" (i projektuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit e Komunës së Skenderajt, në tekstin e mëtejme DUMA).

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshje zhvillimi është pajtueshmëria mes palëve me qëllim të përcaktimit të bonuseve të sakta të zonimit (stimulimeve) të cilat i pranon (aplikuesi) për realizimin e përfitimit publik të Komunës së Skenderajt, projekti me titull: Rehabilitimi i Sheshit para Shtëpisë së Kulturës në Skenderaj

Neni 3
Obligimet e aplikuesit

3.1. Obligohet të financojë projektin “Rehabilitimi i Sheshit para Shtëpisë së Kulturës në Skenderaj”, bazuar në projektin e paraparë nga DUMA – Komuna Skenderaj, në vlerë prej **10,060.00 € (Euro)**.

3.2. Aplikuesi merr përsipër të sigurojë (ofrojë) Komunës zhvillimin e projektit të cekur në nenin 1 të kësaj marrëveshje, në këmbim të bonusit të zonimit që i ofron Komuna.

Neni 4
Obligimet e Komunës

4.1. Komuna merr përsipër që në këmbim të Rehabilitimit të Sheshit para Shtëpisë së Kulturës në Skenderaj, bazuar në projektin e paraparë nga DUMA Skenderaj, t’i ofrojë aplikuesit:
-bonus zonimi për korrigjimin e Lejes Ndërtimore paraprake nr.06-351/02-0024655/21, të datës 07.06.2021, në parcelën 00985-0.

4.2. Për mbikëqyrjen e realizimit të projektit nga aplikuesi dhe përmbushjen e obligimeve të Komunës sipas këtij neni, do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit e Komunës së Skenderajt, si organ profesional për planifikim dhe menaxhim hapësinor.

Neni 5
Plotësimi-Ndryshimi, zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Kjo marrëveshje mund të ndryshohet, plotësohet dhe zgjidhet me marrëveshje, mirëkuptim dhe me pëlqim të palëve nënshkruese të saj, ku çdo ndryshim i saj duhet të bëhet me njoftim paraprak në të shkruar, dhe të integrohet brenda kësaj marrëveshje me një ankes-marrëveshje, si dhe të nënshkruhet nga të dyja palët. Në rast të mosarritjes së zgjidhjes me mirëkuptim, kompetente për zgjidhje të mosmarrëveshjeve është Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega Skenderaj.

Neni 6
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe kopjet

6.1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët nënshkruese, dhe do të zgjasë deri në përmbushjen e qëllimit të përcaktuar në nenet më lartë, ndërsa pas përfundimit të projektit në tërësi, do të shërbej vetëm si dokument dëshmues mbi realizimin e përfitimit publik.

6.2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në katër (4) ekzemplarë të njëjtë, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Palët nënshkruese:
Më 12.07.2024

Komuna e Skenderajt

z.Fadil Nura, Kryetar



“XANI & PARTNERS” SH.P.K.

SH.P.K.
XANI & PARTNERS
SKENDERAJ


z. Ilir Xani, bashkëpronar